

## *Studim –guidë: Njohja dhe zbatimi i modeleve kombëtare dhe lokale për advokim dhe lobim*

**Pjesëmarrës:** Elite OJF nga Kosova

**Financuar nga:** USAID Kosovo FORECAST program, që zbatohet nga World Learning/FORECAST (link tek [www.worldlearning.org](http://www.worldlearning.org))

**Kohëzgjatja:** 26 Prill 2010-1 Maj 2010

**Qëllimi i vizitës:** Shkëmbimi i eksperiencave të suksesshme në fushën e qeverisjes vendore, me fokus në eksperiencat e Institutit të Kërkimeve Urbane për buxhetimin me pjesëmarrje, në 8 qytete të Shqipërisë si dhe për nxitjen përpara të bashkëpunimit ndërkufitar.

**IKU propozoi një program të integruar**, i cili bazohej mbi gërshetimin e një fushe të gjerë të ekspertizës lokale për të ofruar të dhëna teknike të rëndësishme për advokim dhe lobim. Programi përbëhej nga kombinimi i dy komponentëve kryesorë:

**Komponenti 1. Ngritje kapacitetesh:** Sesionet e trajnimit të organizuara nga IKU përmbanin



shembuj nga eksperiencat më të mira ndërkombëtare dhe kombëtare, konceptet kryesore dhe ndikimeve pozitive të advokimit dhe lobimit në zhvillimin e një komuniteti, të buxhetimit me pjesëmarrje, të rëndësisë së pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje.

Disa nga temat kryesore të trajtuara gjatë sesioneve të trajnimit janë:

- Një prezantim i qeverisjes lokale dhe procesit të decentralizimit në Shqipëri;
- Mjetet dhe instrumentat e performancës dhe të nxitjes së pjesëmarrjes qytetare në procesin e vendim marrjes;
- Proçesi i buxhetimit, lista e prioriteteve, monitorimi dhe marrja në dorëzim e punimeve me pjesëmarrje te komunitetit;
- Shembuj nga eksperiencia të suksesshme të IKU-t në proçeset me pjesëmarrje qytetare etj.

**Komponenti 2. Vizita në terren për të parë zbatimin praktik të njohurive teorike gjatë vizitave në bashkitë që kanë zhvilluar me sukses projekte me pjesëmarrje qytetare.** Fokusi i vizitave u përqëndrua në takimet me stafin lokal dhe aktorë të tjerë në këto projekte dhe pjesëmarrësit shkëmbyen lirisht opinionet dhe eksperiencat e tyre në ngritje network-u dhe rritje të zërit të shoqërisë civile. Në të njëjtën kohë u organizuan dhe takime më OJF të tjera që operojnë në Tiranë në fushat e advokimit dhe lobimit për të diskutuar dhe përvetësuar njohuri mbi praktikat më të mira në këto fusha.



### *Vizita në bashkinë e Kavajës*

IKU në bashkëpunim me bashkinë e Kavajës po zbaton projektin “Planifikimi i Investimeve Kapitale me Pjesëmarrje Qytetare”. Pjesëmarrësit nga Elite patën mundësinë të shikonin në praktikë rolin e shoqërisë civile në buxhetimin e investimeve kapitale. Vëmendja u fokusua në prezantimin e procesit dhe të aktorëve me rolet përkatëse në çdo fazë, më konkretisht në rolin e qytetarëve në përcaktimin e prioriteteve për investime duke u bazuar mbi kriteret transparente si shëndeti dhe siguria. Një element tjetër i rëndësishëm i këtij projekti është dhe kordinimi i planeve strategjike të zhvillimit për qytetin me kërkesat e qytetarëve në finalizimin e buxhetit të propozuar. Qytetarët nxiten për të marrë pjesë gjithashtu në monitorimin e zbatimit të investimeve të përzgjedhura.



### *Vizita në bashkinë e Korçës dhe Pogradecit*

IKU në bashkëpunim me bashkitë e Korçës dhe Pogradecit po zbaton projektin “Buxhetim dhe Monitorim me Pjesëmarrje Qytetare në bashkitë e Korçës dhe Pogradecit”.



Gjatë këtyre vizitave u mundësua dhe pjesëmarrja në takime konkrete sipas etapave të projektit me Komisione Qytetare dhe u diskutua me përfaqësues nga stafet e bashkive dhe komuniteteve për rëndësinë dhe avantazhet e procesit me pjesëmarrje qytetare. Programi i integruar i eksperiencave praktike ofroi mjaft rezultate pozitive për pjesëmarrësit në këtë trajnim:

- Ngritje kapacitetesh për advokim dhe lobim si kusht paraprak për realizimin me sukses të proceseve të vendim marrjes;
- Njohja me rrugë të reja komunikimi dhe bashkëpunimi ndërmjet institucioneve të qeverisjes lokale dhe komunitetit me qëllim përmirësimin e cilësisë të shërbimeve të ofruara;

- Shkëmbim eksperiencash në fushat e politikave sociale dhe rritjes së ndikimit të shoqërisë civile si një faktor i rëndësishëm për të sjellë ndryshime në Kosovë dhe Shqipëri.

Ky udhëtim me qëllim studimi u realizua me sukses dhe gjithashtu krijoi baza të reja për bashkëpunim të dyanshëm në të ardhmen ndërmjet organizatave.